



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2022:236959

Datë: 09.01.2025

Numri i dokumentit: 06782838

**2022:236960**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL**, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me bashkëpunëtorin profesional Shkelzen Polloviqi, në çështjen penale kundër të pandehurit D.M nga fsh. ...., për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1708/2022, të datës 11.11.2022, ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor publik, më datë 26.12.2024, në prani të prokurorit të shtetit Gazmend Salihu, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij me autorizim av. Skender Jetishi dhe po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 09.01.2025 përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

I pandehuri D.M., nga i ati Sh., e ëma V., mbiemri i vajzërisë I., i lindur me datë . në fsh.... K. ..., ku dhe tani jeton , me numër personal ....., i shkurorëzuar, baba i një fëmije, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shollën e mesme, punëtor, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë për ndonjë vepër penale, ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale.

### Ë S H T Ë F A J T O R

Me 10 Shtator 2022, rreth orës 17:25, në rrugën e “.....”, në ....., me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme e që vetit t’i sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, ka siguruar shërbime për të cilat e ka ditur se mundësohen vetëm me shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime të tilla, në atë mënyrë që në pompën e derivateve “.....”, furnizohet me derivate të naftës në shumën prej 20.00 € (njëzet euro), pastaj largohet pa e kryer pagesën.

Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.3 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 8, 17, 21, 69, 70, 81, 82 e 493 dhe nenit 314 par. 3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe në bazë të neneve 364, 452, 460, të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), të pandehurit i shqipton:

### **VËREJTJE GJYQËSORE**

Me të cilën të pandehurit i bëhet me dije se ka kryer vepër të dëmshme dhe të rrezikshme që përbën vepër penale dhe nëse kryen prapë vepër të tillë, gjykata do ti shqiptoj sanksion më të rëndë penal.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro (njëzet euro), si dhe konform nenit 36 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 /njëzet/ Euro, që të dy shumat brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

E dëmtuara ....., rruga e “.....” në K. ....., siç shihet nga shkresat e lëndës ka realizuar dëmin e shkaktuar nga i pandehuri.

### **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm me aktakuzën e saj PP.II.nr. 1708/22, e datës 11.11.2022, ka ngarkuar të akuzuarin për veprën penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.3 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe t’i shqiptohet sanksioni penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale te paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar i akuzuari gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku është kryer ose tentohet të kryhet vepra penale.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin gjyqësor fillestar me dt.26.12.2024 në të cilin shqyrtim gjyqësor ishin të pranishëm Prokurori i shtetit i pandehuri dhe mbrojtësi i tij-avokati.

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka udhëzuar të pandehuri për të drejtat e tija në kuptim të nenin 241 par.1 të KPPRK-së. Dhe pasi që i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i cili dhe me këtë rast ka bërë rikualifikimi e veprës penale nga neni 314 par.1 në nenin 314 par. 3 për shkak të shumës së dëmit të shkaktuar dhe pasi që gjyqtari është bindur se i pandehuri e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe rikualifikimin e bërë nga prokurori i shtetit, në pajtim me neni 241 paragrafi 4 të KPPRK-së, i ka afruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pa fajësinë për veprën penale për të cilën është i akuzuar.

I pandehuri në shqyrtimin gjyqësor fillestar ka deklaruar, e pranoj fajësinë për veprën penale që më ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave të saja, për veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.3 të KPRK-së, jam i njoftuar me pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e fajit e bëj në mënyrë vullnetare pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin tim, ndihem thellë i penduar, e di që kam gabuar por për momentin kam qenë pak a shumë i hutuar dhe vlen të ceket se pasi jam thirrur nga policia për këtë rast meni herë kam shkuar tek pompa e benzinës ku kamë marr derivate të naftës dhe e kamë bërë pagesën me dt. 13.10.2022 dhe si dëshmi posedoj dëshminë, është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin dhe premtoj se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepër të tillë apo tjetër penale.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaron: nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit i akuzuar për veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.3 të KPRK-së, pasi që ky pranim është bërë konform nenin 242 të KPPRK-së, dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësen e tij, andaj i propozoj gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë për të pandehurin dhe me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit

gjykata në kuptim të 69 dhe 70 të KPRK-së, ku si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë, në bazë të nenit ndërsa si rrethanë rënduese të merret mënyra e kryerjes së veprës penale, në bazë të nenit 493 par. 2 të KPRK-së, propozoi gjykatës që në rastin konkret për shkak të peshës së veprës penale të pandehurit ti shqiptohet vërejtje gjyqësore, pasi që i njëjti edhe menjëherë pas kryerjes së veprës penale i ka kompensuar dëmin palës së dëmtuar.

Mbrojtësi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë së të pandehurit deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë së të mbrojturit tim, pranimi i fajësisë u bë në mënyrë vullnetare pas konsultimeve të mjaftueshëm me mua si mbrojtës, konform nenit 242 par. 1 dhe 2 të KPPK-së, është pënduar thellë dhe premtori se në të ardhmen nuk do të përsërisë këso veprime dhe po ashtu pajtohem me propozimin e prokurorit të shtetit që të pandehurit ti shqiptohet vërejtje gjyqësore.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 242 par. 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajit është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, pranimi i fajit mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siç janë: Raporti i policit hetues, deklaratat, CD-ja, si dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues konform nenit 242 paragrafit 6 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), ashtu siç është theksuar edhe në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në të cilin është përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra e kryerjes

së veprës penale për çka dhe i pandehuri u shpallë fajtor dhe iu shqiptua dënim alternativ siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethana veçanërisht lehtësuese përkatësisht që në shqyrtimin fillestar i pandehura e ka pranuar fajësinë, se më parë nuk ka qenë i dënuar më parë me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, pendimin dhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsërisë kësi lloj vepre penale apo të ngjashme, se i kompezuar e dëmit që i ka bërë palës së dëmtuar, ndërsa rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata duke marrë parasysh faktin se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë si dhe gjitha rrethanat të tjera të rastit konkret, është e bindur se edhe me një Vërejtje Gjyqësore, me cilën të pandehurit i jepet qortim dhe i bëhet me dije se ka kryer vepër të dëmshme dhe të rrezikshme që përbën vepër penale dhe nëse kryen prapë vepër të tillë, gjykata do ti shqiptoj sanksion më të rëndë penal dhe kështu gjykata krijojë bindje se me këtë Vërejtjes Gjyqësore do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i paraparë në nenin 81 të KPRK-së, përkatësisht e njëjta është plotësisht e justifikueshme, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të tij dhe do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi mbi kërkesën pasurore-juridike, është marruar në kuptim të nenit 460 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushall është marr në kuptim të dispozitës së nenit 452 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 36 par 3 pika 3.1, Nr. 08/L-109 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të theksuarave më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**  
**DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**  
**2022:236960 e datës 09.01.2025**

**Bashkëpunëtori profesional**  
Shkelzen Polloviqi

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
Imri Sejda

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë 30 ditësh, llogaritur nga dita e pranimi të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.